



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1759 Prot.

Tiranë, më 12.12.2024

VENDIM

Nr. 23, Datë 12.12.2024

PËR

**CAKTIMIN E PERIUdhËS SË VETËKANDIDIMIT PËR ANËTARË NË  
KOMISIONIN E MBARËVAJTJES SË VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE  
ME STUDENTËT, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1(i), në nenin 46, pikat 1, 2, 3 dhe 6 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 30, pikat 3 (c)/(d) dhe nenin 34 të Statutit të Universitetit të Arteve, në nenin 21, pikat 2 (c) dhe (d) dhe nenin 26 të Rregullores së Universitetit të Arteve, në nenin 4, pika 1(s) të Rregullores së Funkcionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për marrjen e kandidaturave për 3 (tre) anëtarë, përfaqësues të studentëve, 1 (një) për secilën njësi kryesore/fakultet, në Komisionin e e Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në Universitetin e Arteve.
2. 3 (tre) anëtarët e Komisionit, nga 7 (shtatë) anëtarë gjithsej, vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Aplikimet duhet të paraqiten pranë Sekretariatit Teknik të Senatit Akademik, nga data 13.12.2024 deri më datë 18.12.2024, nga ora 08:00, deri më 16:00.
4. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Najada HAMZA



Prof. Arben LLOZI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Kristina LAÇO

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)

